



AKT THEMELIMI DHE STATUT

I SHOQUERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

I shoqerise Tregtare “Monarch Rental” SH.P.K

Mbeshtetur ne Kushtetuten dhe Kodin Civil ne Fuqi te Republikes se Shqiperise , ne ligjin Nr.7512 date 10.08.1991 “ Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private , nismes se lire dhe te veprimtarise private dhe privatizimit” , te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 , “ Per shoquerite tregatre” dhe te ligjit Nr.9723 , date 03.05.2007 “Per Q.K.R dhe formalitetet qe duhe respektuar nga Shoquerite Tregtare , me vullnetin e tij te lire , te shprehur edhe ne nenshkrimin e ketij akt-themelimi ne ortaket :

Individ me pergjegjesi te kufizuar, banues ne Durres , krijoje shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar **“Monarch Rental” SH.P.K** me akt themelimi si vijon:

Formulimi

Formohet shoqeria tregtare private e quajtur **Monarch Rental” SH.P.K.** Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqipetar , ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega. Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaku themelues.

Neni 1 Ortaku

1.1 Themeluesi i shoqerise eshte znj:**Gramos Mera** i datelindjes 20.09.1994 lindur ne Memaliaj Tepelene, i biri i Vero dhe i Silvanes, banues DURRËS, ADEM JASHARI 00690022; Nd. 34; H. 1; DURRËS; DURRËS; 2024; DURRËS. Mbaftes i leternjoftimit me nr.**J40920094F**

Neni 2 Emri

2.1 Emri i shoqerise eshte Monarch Rental” SH.P.K,(me poshte referuar si “Shoqeria”).

Neni 3 Selia e Shoqerise

3.1 Selia e shoqerise eshte me adresë **Lagja nr 14 Shkozet Durres, zk 8516, nr pasurise 1/257 Shqiperi**

3.2 Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj , te hape zyra perfaqesie , dege , te krijoje filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikes se Shqiperise , vetem me vendim te asamblese dhe ortakut te vetem . ne perputhje me legjACIONIN Shqipetare ne fuqi.

Neni 4

Forma Ligjore

4.1 Shoqeria eshte shoqeri Shqipetare dhe eshte krijuar si shoqeri me perqjejesi te kufizuar.

Neni 5


Kohezgjatja e Shoqerise

5.1 Kohezgjatja e shoqerise do te jetë pa afat . Ajo mund shperbehet ne cdo kohe dhe per cfardo lloj shkaku .

Neni 6

Objekti i Veprimtarise

6.1 Dhenie me qira dhe shitje mjeteve te ndryshme automjetesh. Bar-kafe, Lavazh, si dhe parkim automjetesh etj



PJESA II

KAPITALI I SHOQERISE DHE KUOTAT

Neni 7

Kapitali i Shoqerise

7.1 Kapitali fillestar i shoqerise eshte 100.000 (njeqind mijë) Leke e barabarte me 1 kuote qe perben 100 % te kapitalit.

7.2 Kapitali Ortak ndahet si me poshte:

Ortaku i vetem eshte znj. Gramos Mera zoterues i 1 kuote qe perben 100 % te kapitalit.

III STRUKTURAT DREJTUESE TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKEVE

Neni 8 **Pergjegjesia e Kufizuar**

8.1 Ortaket jane pergjegjes deri ne vleren e pjeses se tyre ne kapitalin e Shoqerise. Shoqeria eshte pergjegjese per detyrimet e saj me te gjitha asetet.

Neni 9 **Te drejtat e lidhura me cdo kuote**

9.1 Cdo pjese e secilit Ortak do ti pergjigjet nje vote korresponduese ne mbledhjet e Ortakeve dhe do ti jape Ortakeve te drejten drejten per te marre dividende ne rast shprendarje te fitimit si dhe te drejten e pjeses perkatese qe mbetet pas procedurave te likuidimit ne rast prishje apo likuidimi te Shoqerise.

Neni 10 **E drejta e pjesemarrjes ne mbledhjet e Asamblese**

10.1 Ortaket kane te drejte te marrin pjese ne vendimarrjen e shoqerise ne mbledhjet e Shoqerise.

10.2 Cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne mbledhjet e Shoqerise ose me prokure, te informohet mbi ceshtjet e Shoqerise si dhe te inspektoje dhe kontrolloje librat dhe regjistrat e Shoqerise.



Neni 11 Detyrimet e Ortakeve

11.1 Ortaket kane detyrime te paguajne pjesen e tyre, te marin pjesa ne mbledhjet e asamblese nese ftohen ne menyren e duhur, te mbeshtesin Shoqerine ne kryerjen e veprimeve te saj si dhe te peirmbushin vendimet e mbledhjes se ortakeve dhe organeve te tjera te Shoqerise te cilat jane mare ne menyren e duhur brenda qellimit te organit perkates.

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

Neni 12 Të drejtat dhe detyrimet e Asamblese se per gjithshme

12.1. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gi) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.


12.2. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "e" dhe "ë" të pikës 1 të këtij nenit, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.

12.3. Nëse shoqëria zotërohet nga një ortak, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

12.4 Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rr Ethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

NENI 13 Marrja e vendimeve



- 13.1 Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të këtij ligji, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 13.2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj ose në statut, për çështjet e tjera të renditura në nenin 81 të këtij ligji, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.
- 13.3. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

NENI 14

Thirrja e asamblese se përgjithshme

- 14.1 Asambleja e përgjithshme do te thirret nga Administratoret te pakten njehere ne vit ne seline e Shoqerise ose ne cdo vend nese percaktohet ne njoftim.
- 14.2. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 14.2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij nenit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.
- 14.3. Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë E përgjithshme të shoqërisë, apo një pjesë më të vogël të parashikuar në statut, mund t'i drejojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës, në përputhje me kete të nenit.

NENI 15

Vendimet e mara ne asamblene e përgjithshme

- 15.1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të këtij ligji, ajo mund të marrë



vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 te ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008.

- 15.2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së Kuorumin të përmendorur në nenin 14, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njejtin rend dite.
- 15.3 Cdo ortak ka te drejte te therrase keshilltare ne mbledhjen e asamblese, te cilet do te jene te detyruar te ruajne fshehtesine e mbledhjes.
- 15.4 Vendimet e maledhjes se ortakeve mund te merren dhe pa takimin e ortakeve p.sh me anë te korrespondences se shkruar, telekonferencies, video konferencies dhe te tjera menyra te ngjashme nese te gjithe ortaket kane dhene pelqimin e tyre paraprak dhe identiteti i ortakeve mund te percaktihet pa dyshim.

NENI 16

Drejtimi i mbledhjes se asamblese se përgjithshme

- 16.1 Kryetari i mbledhjes se asamblese se përgjithshme do te percaktohet nga ortaket.
- 16.2 Do te aprovojen apo refuzohen vetem ato ceshtje te cilat jane percaktuar shprehimi i shtetit ne rendin e dites per mbledhjen e asamblese. Diskutimet mbi ceshtje te ndryshme nga ato te rendit te dites mund te behen vetem nese te gjithe ortaket janë pelqimin e tyre.

NENI 17

Procesverbalet e mbledhjes se asamblese se përgjithshme

- 17.1. Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.
- 17.2. Prosesverbal i duhet të përbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.
- 17.3. Prosesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.
- 17.4. Prosesverbal i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.
- 17.5. Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, administratorët, jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, janë të detyruar të publikojnë kopje të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në këtë faqe.



NENI 18
Administrimi i Shoqerise

- 18.1 Administrimi i shoqerise do te behet nga nje administrator,i cili do te perfaqesoje Shoqerine.Gjithashtu,asambleja e pergjithshme mund te caktoje kompetenca perfaqesimi individuale administratorit.
- 18.2 Administratori mund te autorizoje pale te treta qe ti perfaqesoje ne transaksione te vecanta.
- 18.3 Administratori do te organizoje dhe menaxhoje te gjithe aktivitetin e shoqerise.Ai eshte i autorizuar te perfaqesoje Shoqerine ne te gjitha ceshtjet qe kane lidhje me te.
- 18.4 Te drejtat dhe detyrimet e administratoreve burojne nga ligji,ky Status,vendimet e Asamblese se Pergjithshme dhe rregullat e brendeshme te administrimit te Shoqerise.
- 18.5 Duke marre parasysh kufizimet e nenit 12 me siper, administratori ka te drejtat e Meposhtme:
- Perfaqesimin e Shoqerise kundrejt paleve te trete dhe shtetit.
 - Hapjen e lligarive bankare te shoqerise me bankat.
 - Perfundimin e marreveshjeve me pale te treta,leshimin dhe marjen e urdher pagesave.
 - Nenshkrimin e te gjith dokumentave,nxjerrjen e faturave,trasferimet ne monedhe te huaj,flete ngarkesat etj,pagimin e detyrimeve te Shoqerise dhe pranimin e letrave me vlera nga palet e treta.
 - Mbledhjen e detyrimeve qe i takojne shoqerise,dhenien dhe marrien e paradhenieve.
 - Dhenien e moratoriumit debitoreve te Shoqerise,heqjen dore nga padite qe vijnë si pasoje e mardhenieve te shoqerise nga palet e treta dhe/ose pranimin e ketyre padive.
 - Punesimin dhe shkarkimin e stafit te shoqerise,percaktimin e pagave,shperblimeve dhe pagesave te stafit.
 - Marjen e masave paraprake per mbrojtjen e interesave te Shoqerise,fillimin e padive dhe marjen persiper te mbrojtjes se Shoqerise ne rast te padive kunder saj,administratoret mund te udhezojne avokatet te mbrojne Shoqerine dhe mund te percaktojne shumen e shperblimit te tyre,administratoret kane te drejte te ngrene padi dhe ti heqin ato,te nenshkruajne mareveshje gjyqesore,te myllin mareveshje arbitrazhi,te caktojne arbitra,te terheqin padite e ngritura nga Shoqeria dhe te nderprejne procedimet.
 - Administratoret kane te drejte te marin cdo vendim tjeter qe i takon aktivitetit te perditshem te Shoqerise nga pikepamja e ligjit dhe ketij Statuti,
 - Mbledhjen e shpenzimeve te Shoqerise.
 - Administratoret jane perqejges per mbajtjen e llogarive ne perputhje me ligjin dhe parimet e ligjit.
 - Administratoret jane perqejges per perqatitjen dhe nenshkrimin e bilancit vjetor dhe pasqyrave vjetore financiare te Shoqerise dhe kontrollin e tyre nga nje auditor i jashtem nese dicka e tille kerkohet nga ligji apo vendimi i mbledhjes se



ortakeve.

- Thirrjen e mbledhjeve te ortakeve, percaktimin e rendit te dites, monitorimin e perm bushjes se dispozitive qe kane lidhje me thirrjen dhe drejtimin e mbledhjes se ortakeve per shpalljen e vendimeve te vecanta.
- Publikimin e shpalljeve te nevojshme perfshire dhe publikimin e pasqyrave vjetore financiare.
- Administratoret jane perjegjes per mbajtjen e rregullt dhe ruajtjen e dokumentacionit te Shoqerise.
- Marin vendime mbi te gjitha ceshtjet e tjera qe lidhen me aktivitetine brendshem te Shoqerise dhe maredheniet e saj te jashtme.
- Nenshkrim marreveshjesh dhe kryerja e cdo veprimi ne funksion te administrimit te shoqerise.

18.6 Personi I me poshtem do te caktohet administrator me afat 5 (pese vjecar).

Gramos Mera i datelindjes 20.09.1994 lindur ne Memaliaj Tepelene, i biri i Vero dhe i Silvanes, banues DURRËS, ADEM JASHARI 00690022; Nd. 34; H. 1; DURRËS; DURRËS; 2024; DURRËS. Mbajtes i leternjoftimit me nr. **J40920094F**

VITI FINANCIAR,BILANCI,FITIMI DHE HUMJET

NENI 19

Viti finanziar,pasqyrat financiare vjetore

- 19.1 Viti finanziar i Shoqerise zgjat 12 muaj dhe fillon ne diten e pare te Janarit e mbaron ne diten e tridhjetee te Dhjetorit, Viti i pare finanziar i Shoqerise fillon ne daten e regjistrimit te Shoqerise dhe mbaron ne daten tridhjete e nje-te Dhjetorit.
- 19.2 Ne fund te cdo viti finanziar, administratoret do te perm bushin detyrat e me poshtme:
- (a) Pergatitje e nje liste te detauar te aseteve te Shoqerise dhe struktura se tyre.
 - (b) Pergatitjen e bilancit te shoqerise i cili pershkruan situaten financiare te Shoqerise.
 - (c) Pergatitjen e llogarive te fitimit dhe te humbjeve.

NENI 20

Fitimi i Shoqerise

- 20.1 Fitimi neto i Shoqerise do te shperndahet ne perputhje me pjeset e kapitalit ne Shoqeri.
- 20.2 Fitimi neto do te jete fitimi i Shoqerise ne peruthje me pasqyrat financiare vjetore te miratuara pas zbritjes se te gjitha taksave dhe caktimit te rezervave ligjore. Bilanci i Shoqerise do te miratohet nga asambleja e ortakeve dhe do te dorezohet ne organet

tatimore perpara fundit te muajit Mars te vitit pasardhes.

NENI 21 **Prishja dhe Likujdimi**

21.1 Shoqeria do te zgjidhet ne rastet e meposhtme:

- (a) Vendimi i mbledhjes se asamblese se ortakeve.
- (b) Bashkimi me nje shoperi tjeter.
- (c) Vendimi i gjykates me juridiksion perkates ne rastet e parashikuara me ligj.
- (d) Ne te gjitha rastet e tjera te parashikuara me ligj.

21.2 Likujdimi i Shoqerise dhe shperndarja e aseteve te Shoqerise do te behet ne perputhje me dispozitat ligjore.

NENI 22 **Largimi i ortakut per shkaqe te arsyeshme**

22.1 Ortaku mund te largohet nga Shoqeria nese ortaket e tjere ose Shoqeria kryer veprime ne dem te tij,nese eshte penguar te ushtroje te drejtat e tij,nese Shoqeria i ka ngarkuar detyrime te paarsyeshme apo per shkaqe te tjera,qe e bejne te pamundur vazhdimin e ortakerise.

22.2 Ortaku qe kerkon largimin,duhet te njoftoje Shoqerine me shkrim,si dhe te parashtroje shkaqet e largimit.

22.3 Administratoret duhet te therrasin mbledhjen e asamblese se per gjithshme menjehere pasi te kene marre dijeni per njoftimin e largimit,sipas pikes 2 te ketij neni,per te vendosur nese ortakut do ti likuidohet kuota,si pasoje e largimit per shkaqe te arsyeshme.

22.4 Ortaku ka te drejte te ngreje padi ne gjykate ndaj shoqerise per likujdimin e kuotes,si pasoje e largimit per shkaqe te arsyeshme,nese pas njoftimit te largimit asambleja e per gjithshme nuk mbildhet apo nuk i njeh si te arsyeshme shkaqet e largimit dhe likuidimin e kuotes.

22.5 Ortaku qe kerkon largimin nga shoqeria,detyrohet ta demshperbleje shoqerine per demet e shkaktuara,nese rezulton se largimi eshte kryer ne baze te shkaqeve te paarsyeshme.

22.6 Ortaku qe largohet ka te drejte te ngreje padi ndaj shoqerise dhe/ose ortakeve te tjere qe shkaktuan largimin e tijdhe te kerkoje ndaj tyre,ne menyre solidare,shperblimin e demit te pesuar.

Durrës 2018

NENI 23 Perjashtimi i ortakut

- 23.1 Ne baze te nje vendimi te zakonshem,asambleja e pergjithshme mund ti kerkonte gjykates perjashtimin e ortakut,nese ai nuk ka shlyer kontributin e tij,sipas parashikimeve te statutit ose nese ekzistojne shkaqe te tjera te arsyeshme per kete perjashtim.
- 23.2 Konsiderohen shkaqe te arsyeshme per perjashtimin e ortakut,sipas pikes 1 te ketij neni,por pa u kufizuar ne to,rastet kur ortaku:
- Me dashje apo pakujdesi te rende i shkakton deme shoqerise ose ortakeve te tjere:
 - Me dashje apo pakujdesi te rende shkel statutin ose detyrimet e percaktuara me ligj:
 - Perfshihet ne veprime,te cilat e bejne te pamundur vazhdimin e mardhenieve midis shoqerise tregtare dhe ortakut,ose
 - Me veprimet e tij demton ose pengon ndjeshem veprimitarine tregtare te shoqerise.
- 23.3 Shoqeria ka te drejte ti kerkonte ortakut te perjashtuar shperblimin e demit te pesuar nga veprimet,qe kane sjelle perjashtimin.
- 23.4 Ortaku ka te drejte ti kerkonte shoqerise shperblimin e demit te pesuar,nese kerkesa per perjashtim nuk eshte e bazuar.
- 23.5 Ortaku nuk ka te drejte ti kerkonte shoqerise likuidimin e kuotes,nese ai perjashtohet per shkaqe te arsyeshme,por,nese shoqeri ngre ndaj tij padi per shperblim demi,ortaku ka te drejte ta kompensoje cdo shume,qe do kishte te drejte te perfiton te cilesine e likuidimit te kuotes,me demin e kerkuar nga shoqeria.

NENI 24 Te pergjithshme

- 24.1 Ne rast mosmarrreveshjes te cilat lindin si pasoje e keti statuti ose per shkak te ligjet,ortaket do te perpiqen ti zgjidhin ato miqesish.Nese nuk arrihet nje marreveshje,mosmarrreveshja e ortakeve do te zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqesore Durrës.
- 24.2 Ligji zbatues eshte ligji shqiptar.
- 24.3 Ky status hartohet dhe nenshkruhet ne 5(pese) kopje origjinale.

ORTAKU I VETEM
Gramos Mera

Gramos Mera


**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE DURRËS
NOTER EDRA SH. VRIONI**

**DATE 03/09/2021
NR REP 2465**



V2021011230116729708

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë **03.09.2021**, para meje Notere **EDRA SH. VRIONI**, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore DURRËS, me zyrë në adresën Durres, NR.4, EGNATIA, PALLATI DOVANA , u paraqit personalisht:

NËNSHKRUUES/IT:

Gramos Mera, atësia Vero, amësia Silvana, shtetas Shqiptar, lindur në Memaliaj, Tepelene dhe banues në DURRËS, me adresë Adem Jashari 00690022; Nd. 34; H. 1; Durrës; Durrës; 2024; Durrës, lindur më 20/09/1994, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 031967137 dhe nr. personal **J40920094F**,

Subjekti i mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitë dhe nënshkroj përpara meje Noteres, "**Akt Themelimi dhe Statutin e shoqerise Monarch Rental shpk**", bashkëlidhur.

Unë Noterja, pasi verifikova identitetin e personit të sipërcituar, nëpërmjet mjetit të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gëрма "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

EDRA SH. VRIONI

Eduard Ujioniu